

**VENDIM**  
**Nr.11, datë 15.3.2007**

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË  
PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

|                    |           |
|--------------------|-----------|
| Z. Genc Ruli       | - Kryetar |
| Znj. Mimoza Dhëmbi | - Anëtare |
| Znj. Mimoza Vokshi | - Anëtare |
| Z. Viktor Gumi     | - Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr. AI/006/1/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës janë nenet 6 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”.

Objekti/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit, që marrin në punësim të përkohshëm ose në punësim prove persona punëkërkues të papunë nga lista e zyrës së punësimit, nëpërmjet një financimi mujor të pagës dhe të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme të këtyre personave.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

**VËREN SE:**

1. Skema synon të mbështesë ndërmarrjet që mundësojnë marrjen në punësim të përkohshëm ose në punësim prove të punëkërkuesve të papunë nga lista e zyrës së punësimit.

2. Skema paraqitet shumë komplekse dhe nuk ka kritere të qarta për llogaritjen e intensitetit, për kohëzgjatjen e saj, si dhe për monitorimin e impaktit që sjell zbatimi i secilës prej pikave të vendimit.

3. Në skemë nuk janë parashikuar dispozitat sanksionuese për mospërbushjen nga ana e ndërmarrjeve të detyrimeve të tyre në kuadër të skemës dhe as mënyra e raportimit të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e saj.

4. Duke shqyrtuar në tërësi vendimin, si dhe duke marrë parasysh që në analizë përfshihen edhe vlerat e pagesës së papunësisë dhe ndihmës ekonomike është pothuajse e pamundur që, me mënyrën sesi është parashikuar në vendim, por edhe në bazë të të dhënave që janë vënë në dispozicion nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të llogaritet dhe të vlerësohet intensiteti i ndihmës për të gjithë skemën, pra intensiteti total i saj.

**PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “c”, paragrafi 2 dhe nenit 23 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 19 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005,

**PROPOZON:**

1. Skema të rishikohet tërësisht, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin për ndihmën shtetërore.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të përcaktojë saktë vlerën e intensitetit të ndihmës për çdo komponent të dhënë në skemë, si dhe vlerën e intensitetit total në kuadër të gjithë skemës.

3. Të përcaktohet afati përfundimtar i mbarimit të skemës.

4. Të parashikohet që të gjitha ndërmarrjet që nuk plotësojnë detyrimet e tyre në kuadër të

skemës, të kthejnë të gjithë ndihmën/subvencionin e marrë, së bashku me interesat.

5. Të parashikohet që autoriteti përgjegjës për zbatimin e skemës duhet të raportojë, brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për zbatimin e skemës në vitin paraardhës financiar. Këto të dhëna duhet të ruhen deri në 10 vjet pasi është dhënë ndihma/subvencioni i fundit në kuadër të skemës.

6. Çdo projektakt normativ i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuesve të papunë”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Genc Ruli**